UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr.240, datë 16.12.2022

PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS SË INVESTIMIT PËR PAJISJEN ME LEJE UNIKE PËR INVESTITOR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 6, të nenit 69, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt",

UDHËZOJMË:

1. Vlera e investimit për aktivitetin ekonomik, për të huajin që pajiset me leje unike si investitor, të jetë jo më pak se 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë.
2. Ngarkohet Departamenti për Kufirin dhe Migracionin dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj